



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E lidhur me datën 26.11.2018 ne Lipjan ndërmjet

Komunës se Lipjanit te cilën e përfaqëson drejtorit të Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Adem Duriqi ne njërën ane (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues, dhe

Emri i Kontraktuesit **"Urban events & marketing"**- Fushë Kosovë të cilën e përfaqëson Blerant Lila (në anën tjetër) në tekstin e mëtejshëm kontraktuesi.

Titulli i kontratës: Dekorimi i sheshit dhe qytetit te Lipjanit me rastin e festave te fundvitit 2018 me numër Identifikues 613 018 096 236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Dekorimi i sheshit dhe qytetit te Lipjanit me rastin e festave te fundvitit 2018, siç janë: Sherbimi me topa me diametër 50x50 të mbështjellur me drita LED me vazhduese, Sherbimi me drita festive (Kabllo), dekor i bredhit ose gjethe bredhi 4m, shirita dekorues një ngjyrësh, 2m x 5 cm, fjongo dekorativë 30 x 30cm , furnizimi me mjete piroteknike (fishekzjarre) 38x38x24.5 cm 100 Gjuajtje, sherbim me Shtëpiza druri 2x1.5m, te cilat duhen te vendosen ne Sheshin "Adem Jashari" ne Lipjan nga data 20.12.2018 deri me 04.01.2019 etj. Sipas paramases se cekur më poshtë.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrim të kontratës gjegjësisht më 05.12.2018 dhe do të përfundojë 05.01.2019 .

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: Qyteti i Lipjanit

-Sheshi "Adem Jashari"

-Rruga "Shqiperija" se bashku me oborrin e objektit te komunes.

OE obligohet qe te vendose te gjitha elementet e paramases ne vendet e caktuara nga AK. Pas perfundimit OE obligohet qe te zhvendos dhe te pastroj ambientin ku jane kryer sherbimet. OE

Kto sherbime oblogohet qe t'i vej ne dispozicion te komunes nga data 20.12.2018 deri me 4.01.2019

Dekorimet dhe te gjitha shëbimet tjera nuk mbeten ne pronsi te AK pas perfundimit te Festave te fundvitit

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i përgjithshëm për kryerjen e shërbimeve dekorimi i qytetit me rastin e festave të fundvitit shprehur në shifra është **9150.00 €**; shprehur me shkrim nëntmijë e njëqind e pesëdhjet / Euro/ zero /cent/.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bresës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet pas kryerjes së furnizimit dhe shërbimeve në bazë të raportit nga menaxheri i kontratës se janë përfunduar shërbimet me sukses dhe nuk ka vërejtje në shërbimet e kryera.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të inspektojë, kontrollojë, furnizimet dhe shërbimet nga ana e OE në mënyrë që të përcaktoj nëse janë kryer sipas parametres dhe paralogaris në kontratë.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 18 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen Shqip në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Blerant Lila	Emri:	Adem Duriqi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
1	Sherbim me topa me diametër 50x50 të mbështjellur me drita LED me vazhduese.	Copë	150	2.5	375
2	Sherbim me topa diametër 20x20 të mbështjellur me drita LED me vazhduese.	Copë	500	1	500
3	Sherbim me topa me diametër 10x10 të mbështjellur me drita LED me vazhduese.	Copë	300	0.5	150
4	Sherbim me drita LED dekoruese me 100 trupa ndriques të mëdhenjë. Min 7m.	Copë	500	0.75	375
5	Sherbim me drita LED dekoruese me 100 trupa ndriques standard. Min 10m	Copë	700	1	700
6	Sherbim me drita festive (Kabllo)	Metër	1000	0.5	500
7	Dekor i bredhit ose gjethe bredhi 4m.	Copë	100	0.35	35
8	Sherbim me topa dekorues të ndryshem 20x20cm	Copë	1500	0.2	300
9	sherbim me topa dekorues një ngjyrë. 5 copë kompleti 5x5 cm	Copë	300	0.9	270
10	Shirita dekorues një ngjyrësh, 2m x 5 cm	Copë	300	0.7	210
11	Reflektorë 50ë LED me mbajtëse.	Copë	20	10	200
12	Kabëll e rrymës 3 x 2.5	Metër	500	1.5	750
13	Fjongo dekorativë 30 x 30cm	Copë	50	6.5	325
14	Fjongo dekorativë 20x20 cm	Copë	50	5	250
15	Kaprollë dekorativë me drita festive kabllo 1mx70cm	Copë	20	15	300
16	Hekur për improvizim të bredhave, 4x4 cm, l plotë.	Copë	12	5	60
17	Fjongo dekorues nga stiropori dim 2x1.5m	cope	5	25	125
18	Furnizim me mjete piroteknike (fishekzjarre) 38x38x24.5 cm 100 Gjuajtje	Copë	3	35	105
19	Furnizim me mjete piroteknike (fishekzjarre) 17x17 cm 500 Efekt vullkan.	Copë	2	150	300
20	Furnizim me mjete (fishekzjarre) 61x52x32 cm 193 Gjuajtje	Copë	1	95	95
21	Furnizim me mjete(fishekzjarre) 78x67x25 cm 268 Gjuajtje	Copë	1	210	210

22	Furnizim me mjete (fishekzjarre) 67x39x25 cm 150 Gjuajtje	Copë	2	322.5	645
23	Furnizim me mjete (fishekzjarre)70x120x36 cm 25 Gjuajtje	Copë	2	135	270
24	Sherbim me Shtëpiza druri 2x1.5m,te cilat duhen te vendosen ne Sheshin "Adem Jashari"ne Lipjan nga data 20.12.2018 deri me 04.01.2019	Copë	7	300	2100
25	Bredh dekorativ me lartesi 3m me ndriqim	Copë	1	500	500
	Totali:				9,150.00